



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:179470

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747294

KPPP.nr.1511/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., me NRB:70025959, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK” nr.51, kundër debitorit N.T.P. “Tini”, me NRB:70269490, me seli në Ferizaj, rruga “Enver Topalli”, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbartim, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., dhe debitorit N.T.P. “Tini”.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin PPP.nr.188/22, të datës 12.04.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për

vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kreditori lidhur me këtë çështje përmbarimore, propozimin për përmbarim e ka paraqitur në Gjykatën Komunale në Ferizaj, me datën 21.01.2011, ndërsa Gjykata ka lejuar përmbarimin e propozuar përmes Aktvendimit E.nr.28/11 datë 21.01.2011.

Përfaqësuesi i përkohshëm i debitorit me datë 04.11.2014 ka paraqitur propësim kundër Aktvendimit E.nr.28/11 të Gjykatës Themelore ne Ferizaj.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktvendimin E.nr.28/11 të datës 24.08.2015, ka refuzuar si të pabazuar propësimin e përfaqësuesit të përkohshëm të debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr.28/11 të datës 21.01.2011.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.3876/15 të datës 25.11.2015, ka hedhur poshtë si të pa afatshme ankesën e përfaqësuesit të përkohshëm të debitorit të ushtruar kundër aktvendimit E.nr.28/11 të datës 24.08.2015, të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Gjykata Themelore në Ferizaj në seancën e mbajtur me datë 02.07.2019, ka aprovuar propozimit e kreditorit dhe lëndën me numër E.nr.28/11, e ka transferuar tek Përmbaruesi Privat Bardh Tasholli në Ferizaj, e cila ka marr numrin P.nr.317/19.

Përmbaruesi Privat me datë 20.07.2019, ka nxjerrë konkluzionin me numër P.nr.317/19, për mënyrën e përcaktimit të vlerës së paluajtshmërisë dhe konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal.

Me Konkluzionin e marrë në procesverbalin për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal të datës 30.08.2019, është aprovuar propozimi i përfaqësuesit të kreditorit dhe është caktuar seanca e dytë e ankandit publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë.

Me Konkluzionin e marrë në procesverbalin për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e dytë publik verbal të datës 27.09.2019, është aprovuar propozimi i përfaqësuesit të kreditorit dhe paluajtshmëria e evidentuar në ngastrën kadastrale me Certifikatën nr. UL-72217039-00273 datë 04.03.2008, i është shitur kreditorit Raiffeisen Bank me seli në Prishtinë në shumën prej

10.420.00 €, ndërsa me datë 05.11.2019 Përmbauesi Privat ka nxjerrë urdhër për konstatimin se paluajtshmëria i është shitur personit të caktuar.

Me datë 23.12.2019, debitori ka paraqitur ankesë ndaj urdhrin të Përmbauesit Privat P.nr.317/2019 të datës 05.11.2019.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.1150/2020 të datës 30.11.2021, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit N.T.P. Tini dhe ka anuluar urdhrin për shitje të Përmbauesit Privat Bardh B. Tasholli P.nr.317/19 të datës 05.11.2019 dhe lënda i është kthyer të njëjtit në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përmbauesi Privat me datë 21.04.2022, ka nxjerrë konkluzionin me numër P.nr.317/19, për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal dhe seanca e parë e ankandin publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë është caktuar për datën 27.05.2022.

Përmbauesi Privat me Konkluzionin P.nr.317/19 të datës 27.05.2022 ka shtyrë përmbarimin sipas kërkesës së kreditorit.

Përmbauesi Privat me datë 27.06.2022, ka nxjerrë konkluzionin me numër P.nr.317/19, për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal dhe seanca e parë e ankandin publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë është caktuar për datën 27.07.2022.

Me Konkluzionin e marrë në procesverbalin për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal të datës 27.07.2022, është shtyrë seanca e ankandit të parë publik verbal në mungesë të debitorëve dhe është caktuar që seanca e dytë e ankandit publik të mbahet me datë 29.08.2022.

Përmbauesi Privat me datë 27.07.2022, ka nxjerrë konkluzionin me numër P.nr.317/19, për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal dhe seanca e parë e ankandin publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë është caktuar për datën 29.08.2022.

Me Konkluzionin e marrë në procesverbalin për shitjen e paluajtshmërisë me ankandin e parë publik verbal të datës 29.08.2022, është shtyrë në kohë të pacaktuar seanca e ankandit të parë publik verbal sipas konkluzionit për shije numër P.nr.317/19 të datës 29.07.2022, në mungesë të debitorëve, meqenëse për të njëjtit nuk ka pasur dëshmi se janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Me Akt përcjellësin e datës 01.09.2022 lënda me numër P.nr.317/2019, është kthyer në Gjykatën Themelore në Ferizaj, sipas propozimit të kreditorit të bërë në seancën e ankandit të parë publik verbal të datës 29.08.2022, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të debitorit.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktvendimin PPP.nr.188/22 të datës 12.04.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për vendosjen në prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim P.nr.317/19 të datës 05.11.2019.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka mjet juridik, përkatësisht prapësim për vendosje nga ana e Gjykatës Komerciale, meqenëse kjo çështje përmbarrimore është në fazën e ekzekutimit, përkatësisht në fazën e shitjes së paluajtshmërisë së debitorit përmes ankandit publik me qëllim të realizimit të kërkesës së kreditorit, andaj në këtë fazë të procedurës, Gjykata Komerciale nuk ka kompetencë për të vendosur për çfarëdo lloj kërkesë, pasi që kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarrimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarrimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarrimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarrimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarrueshëm për përmbarrimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt ekzekutimin e përmbarrimit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedure përmbarrimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarrimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përbarimore është ekzekutimi i përbarimit nga gjykata si organ përbarues sipas propozimit për përbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1511/23, datë 28.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.